

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
“PËR
POLITIKAT KOMBËTARE PËR RIORGANIZIMIN E SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT, TRAJTIMIT DHE
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është vendosja e politikave kombëtare për reformimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të kanalizimeve për të gjithë popullsinë rezidente të Shqipërisë në përmbushje të vizionit të Strategjisë Kombëtare për një sistem të besueshëm mbarëkombëtar për furnizimin me ujë dhe kanalizimë që plotëson nevojat të një ekonomie në zhvillim duke mbrojtur mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve.

Qeveria e Shqipërisë ka prioritet parësor sigurimin e shërbimeve të sigurt dhe të besueshme të furnizimit me ujë dhe kanalizime, të menaxhuara në mënyrë eficiente dhe të sigurt dhe planifikon mbështetjen e nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm kombëtar, rritjen e standardeve të jetesës dhe mirëqenien e popullsisë dhe përmirësimin e konsiderueshëm të shëndetit.

Sigurimi i ofrimit të shërbimit me ujë të pijshëm të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë deri në vitin 2030 kërkon investime madhore në infrastrukturë, sigurimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime sanitare dhe ruajtjen e higjienës në çdo nivel.

Qeveria shqiptare vlerëson se sfida për të reformuar sektorin ujësjellës kanalizime kërkon instrumente efektive që do të mundësojnë maksimalizimin e të gjithë përpjekjeve për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve mbi një kuadër të qëndrueshëm financiar dhe në respekt të mjedisit. Studimet e kryera në kohë të ndryshme kanë konkluduar që agregimi i shërbimeve me pjesmarrjen aktive të institucioneve qendrore, shikohet si e vetmja rrugë për të përmirësuar efektivitetin e shërbimeve dhe

për ta shndërruar gradualisht sektorin në një stad më të qëndrueshëm financiar dhe teknik.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2022.

Projektvendimi vjen si nevojë e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për furnizimin me ujë dhe kanalizime (draftuar në vitin 2019) e cila përcakton për shqyrtim nga Këshilli i Ministrave objektivat kryesore dhe prioritetet për sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në vend si dhe propozon për zbatimin dhe financimin e politikave për arritjen e këtyre objektivave brenda një horizonti kohor 10 vjeçar (2020-2030).

III. PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME TË KËTIJ PROJEKTVENDIMI

Referuar performancës së dobët që ka paraqitur sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizime, e cila vjen nga performanca e dobët komerciale e kombinuar me nivele të larta të humbjeve të ujit konkretisht:

- Norma e ujit pa të ardhura është shumë e lartë e llogaritur në nivelin 65.5 %,
- Humbje të lartë financiare ku pjesa më e madhe e shoqërive UK nuk arrijnë të mbulojnë kostot operative direkte.
- Borxhe të larta ndaj subjekteve buxhetore dhe jobuxhetore.
- Detyrime të larta për kredi, për të cilat shteti ka dalë garant dhe janë të njohura për tu paguar nga UK kundrejt Ministrisë së Financave.

- Fragmentizimi i shërbimit në 57 shoqëri ku vetëm 2 prej tyre UK Tiranë dhe UK Durrës mbulojnë rreth 40% të numrit të konsumatorëve

Mbështetur edhe në gjetjet dhe rekomandimet nga studimet e kryera nga partnerët ndërkombëtarë që mbështesin Qeverinë Shqiptare, si dhe studimeve kombëtare në kuadër të përmirësimit të shërbimit të furnizimit me ujë, grumbullimin e trajtimit e ujërave të ndotura urbane, rezulton se agregimi i shoqërive me numër të ulët të abonentëve duke krijuar shoqëri të konsoliduara me strukturë të përbashkët përmirëson:

1. Eficiencën ekonomike nëpërmjet ekonomive të shkallës;
2. Akses në burimet ujore dhe menaxhim të integruar të burimeve ujore;
3. Performancën e treguesve tregtare të UK;
4. Profesionalizmin dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore;
5. Ndikimin në mjedis;
6. Mundësitë për financim dhe rritje të kapitalit;

Sjell si domosdoshmeri reformimi e sektorit të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të kanalizimeve.

Objektivat kryesorë të reformës në sektorin e ujësjelles kanalizimeve në Shqipëri janë:

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për të gjithë popullatën brenda zonës së shërbimeve të shoqërive UK:
 - ✓ Furnizim i pandërprerë me ujë për zonat urbane dhe gradualisht dhe për zonat rurale.
 - ✓ Shërbime të sigurt të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.
- Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në të gjithë territorin.
- Menaxhimi i përmirësuar i kërkesës për ujë.
- Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare për shoqëritë ujësjellës kanalizime:

- ✓ Harmonizim gradual i tarifave në zonën e shërbimit sipas ndarjeve territoriale të bashkive;
- ✓ Rritja e faturimeve dhe arketimeve në të gjithë zonën e shërbimit.
- ✓ Hartimi i programit për administrimin e borxhit/kredive:
 - Administrimi eficient i borxhit përmes marreveshjeve të shlyerjes të dakortësuar me konsumatorët debitorë.
 - Administrimi eficient i borxhit përmes marreveshjeve të shlyerjes graduale të dakortësuar me OSHEE dhe operatorët e tjerë ekonomik.
 - Organizimi i transfertave graduale drejt buxhetit për shlyerjen e stokut të kredive.
- ✓ Rregjistrimi i aseteve të trashëguara nga projektet e infrastrukturës të financuara nga buxheti i shtetit dhe donatorët (IFN).
- ✓ Hartimi i dhe implementimi i një programi të integruar për administrimin e aseteve.
- Përmirësimi i njohurive të fuqisë punëtore dhe kapaciteteve menaxhuese
 - ✓ Hartimi i strukturave të unifikuara rajonale menaxheriale dhe operacionale;
 - ✓ Alokimi i fondeve në buxhetin vjetor të shoqërisë UK për trajnimin e stafit menaxherial dhe operacional.
 - ✓ Zbatimi i programit të certifikimit të punonjësve të shoqërisë UK
- Përmirësimi i qeverisjes dhe kuadrit ligjor/rregullator të sektorit:
 - ✓ Harmonizimi i kuadrit ligjor kombëtar të sektorit UK në përputhje me direktivat e BE për ujë

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i propozuar është në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të nenit 12 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të Relacion shpjgues për projektvendimin "Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura"

sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

Gjithashtu, ky projektvendim është në përputhje me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, si dhe ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projektvendim nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura” në Republikën e Shqipërisë është hartuar në dy Krerë.

Në Kreun I, janë parashikuar gjithsej 7 dispozita në të cilat përcaktohen në mënyrë të përgjithshme politikat kombëtare, qëllimi i këtyre politikave, si dhe efektet e pritshme nga zbatimi i mundshëm i politikave të përcaktuara. Një shërbim i furnizimit me ujë dhe kanalizime, duke plotësuar nevojat e popullatës, duke qenë ekologjikisht, teknikisht dhe me një efikasitet dhe performancë të cilësisë së shërbimit të barabartë me praktikën evropiane janë synimet kryesore të këtyre politikave të përcaktuara në Kreun I.

Në Kreun II, janë parashikuar dispozita rregulluese për mënyrën sesi mund të riorganizohet sektori i furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.

Pika 1 e këtij Kreu parashikon mundësinë për bashkëpunimin e dy ose më shumë njësive të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre për riorganizimin e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve.

Relacion shpjgues për projektvendimin “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”

Pika 2, parashikon formatin tip të marrëveshjes së bashkëpunimit që do të nënshkruajnë njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe MIE në rastin kur bien dakord për riorganizimin e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës kanalizimeve.

Pika 3, rregullon formën e shoqërive aksionare të reja që krijohen nga marrëveshje ndërmjet palëve, duke i riorganizuar si Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta (SKP), të cilat janë shoqëri të reja aksionare të krijuara sipas sistemit të administrimit me dy nivele, në përputhje me formatin e statutin tip, të përcaktuar në lidhjen nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Pika 4, parashikon procedurën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes sipas kërkesave ligjore.

Pika 5, përcakton që në SKP e reja të krijuara me aksionar MIE, kjo e fundit zotëron jo më pak se 51% të aksioneve me të drejta vote, ndërsa njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë lidhur marrëveshje për riorganizimin e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të tyre zotërojnë bashkërisht jo më shumë se 49% të aksioneve me të drejta vote.

Pika 6, përcakton kapitalin themeltar për secilën SKP të krijuar, i cili do të jetë jo më i vogël se 10.000.000 lekë. Gjithashtu, Shlyerja e vlerës së kapitalit të nënshkruar të bëhet sipas marrëveshjes të nënshkruar nga secila prej palëve, në përputhje me statutin, legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe përqindjen e aksioneve që do të zotërohen prej tyre.

Në pikën 7 është rregulluar transferimi i plotë i veprimtarisë që ushtrohet nga shoqëritë UK, tek SKP-të e krijuara në bazë të marrëveshjeve që do të nënshkruhen. Transferimi i veprimtarisë do të bazohet mbi një kontratë (akt transferimi) të noterizuar, e cila do të nënshkruhet rregullisht ndërmjet palëve (transferuesve dhe marrësit të transferimit) dhe do të regjistrohet në pasqyrat financiare të Shoqërive.

Në pikën 8, përcaktohet që shlyerja e vlerës nominale të aksioneve që do të zotërohen nga MIE do të kryhet duke njohur investimet në proces të cilat janë financuar nga buxheti i shtetit dhe me anë të investimeve kapitale të ardhshme

që qeveria do të ndërmarrë në vitet në vijim në gjithsecilën prej këtyre shoqërive ose nëpërmjet shuarjes me kompensim të detyrimeve që Shoqëritë e Ujësjellës Kanalizime kanë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes ndaj institucioneve të tjera qendrore buxhetore dhe jo buxhetore.

Pika 9, rregullon shlyerjen e kontributeve nga ministria përgjegjëse, të cilat mund të realizohen edhe nëpërmjet të drejtave të vlerësueshme në para, të tilla si kompesimi i vlerës së detyrimeve që shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve kanë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e SKP-së. Aksionerët do të nënshkruajnë kontrate rritje kapitali që investimet e ardhshme dhe fitimi të kapitalizohen dhe të alokohen derisa të arrijnë përqindjen sipas marrëveshjes së krijimit të SKP.

Pika 10, përcakton detyrimin për SKP-të e krijuara për respektimin dhe zbatimin e kontratave të shërbimit të lidhura para krijimit të tyre, detyrimeve kontraktore që burojnë nga marrëveshjet e lidhura nga Këshilli i Ministrave, ministritë e linjës dhe institucionet qendrore, si dhe detyrimet kontraktore nga marrëveshjet e lidhura ndërmjet ish-njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve financiare ndërkombëtare ose shoqërive kontraktuese përkatëse.

Në pikën 11, është përcaktuar që ministria përgjegjëse i akorodn SKP-ve të krijuara, fondet e planifikuara për investime nga buxhetin e shtetit apo nga institucionet financiare ndërkombëtare, në përputhje me parashikimet e dokumenteve strategjike sektoriale në fuqi.

Pika 12 rregullon procedurën për pajisjen me licencë të SKP-ve nga ERRU.

Pika 13, parashikon detyrimet që iu lindin njësive të vetëqeverisjes vendore pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë me qëllim riorganizimin e sektorit të ujit. Më konkretisht është parashikuar marrja e masave nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore për transferimin e plotë të veprimtarisë ekonomike të shoqërive aksionare ekzistuese tek SKP-të e krijuara, si dhe transferimi i veprimtarisë në bazë të aktit noterial.

Pika 14 përcakton që efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi dhe shpenzimet që vijnë nga krijimi i SKP-ve përballohen nga buxheti i shtetit.

Relacion shpjgues për projektvendimin "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura"

Pika 15, parashikon institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, të cilat janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enti Rregullator i Ujit, Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E VENDIMIT

Institucionet kryesore që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi janë Ministrisa e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Brendshme, Enti Rregullator i Ujit, Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqëritë e ujësjetllës-kanalizimeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve.

Ky projektvendim do të dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Entit Rregulator të Ujit, Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare të këtij projektvendimi do të përballohen nga fondi i parashikuar në buxhetin e shtetit për Agjencinë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve.

MINISTRI

Belinda Balluku